



Nr. 6053/, Pril
21. 19.05.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

V E N D I M

Nr. 39, datë 19.5.2021

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, ZONA 5, NJËSIA ADMINISTRATIVE DURRËS, BASHKIA DURRËS”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1, shkronja”b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 442, datë 03.06.2020 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, Vendimit Nr. 19, datë 18.05.2020 të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, Vendimit Nr. 246, datë 30.04.2021 të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale,

VENDOSA:

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Zona 5, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtme:
 - a) Raporti i Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Zona 5, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës;
 - b) Materiali hartografik;
 - c) Paketa e Planvendosjeve për banesat individuale.
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.

3. Plani i Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, të integrohet me dokumentin e Planifikimit në fuqi, duke ndjekur përcaktimet e Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar.
4. Ngarkohet Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

KRYETARI
EMIRIANA SAKO

